

Projekti i Ristrukturimit të KESH

Vendi:	Shqipëri
Numri identifikues i Projektit:	48132
Spektori i Biznesit :	Spektori i Energjisë
Spektori Publik	
Kategoria Mjedisore	B
Data e synuar për bord	22 Qershor 2016
Statusi:	Nënshkruar
Publikimi i PSD (Dokument Permbledhës i Projektit):	22 Mars 2016

Përshkrimi i Projektit

Ky projekt lidhet me një program gjithëpërfshirës reformash në KESH dhe në përgjithësi në sektorin energjistik në Shqipëri të cilat synojnë të përmirësojnë ndjeshëm menaxhimin dhe efikasitetin operacionale të sektorit

Huaja do të përdoret për të rifinancuar dhe zgjidhur afatet e huave afatshkurtra me garanci sovraane që KESH ka marrë nga bankat e nivelit të dytë , për shkak të emergjencave, të cilat kërkojnë aprovim të përvitshëm pa arritur t'i japin zgjidhje krizës së likuiditetit, mungesës së stabilitetit dhe pasigurisë për të ardhmen. Këto hua afatshkurtra nevojiteshin për të lehtësuar barrën e mungesës kritike të likuiditetit të krijuar nga kushtet hidrologjike dhe organizimi i sektorit. Me implementimin e paketës së reformave, performanca e sektorit dhe ajo e vetë KESH duhet të përmirësohen.

Objektivat e Projektit

Qëllimi i përgjithshëm është reformimi dhe rristurimi i KESH dhe i sektorit të energjisë në Shqipëri për të arritur një qëndrueshmëri afatgjatë të munguar deri tani. Investimi i BERZH pritet të mbështesë programin e reformave të cilat synojnë të përfshijnë mirëqeverisjen korporative (corporate governance) në KESH, operimin në treg dhe tregtinë rajonale. Si rezultat i rifinancimit të bilancit me qëllim zgjatjen e afateve të kredive afatshkurtra, KESH do të ketë kontroll më të madh mbi situatën financiare duke u çliruar nga shqetësimet e vazhdueshme për urgjencën e likuiditetit.

Ndikimi në Tranzicion

Projekti mbështet përpjekjet e Bankës në dialogun për procesin e reformimit të sektorit ashtu si edhe mundësitë që vendi të zhvillojë politikat dhe parimet e tregut të brendshëm dhe atij rajonal. Projekti do të promovojë integrimin rajonal dhe tregtinë. Ai do të promovojë gjithashtu adoptimin e një kuadri ligjor sekondar konsistent dhe të nevojshëm për implementimin e Ligjit për Sektorin e Energjisë. Kjo pritet të përfshijë përmirësime në formimin e tarifave. Banka do të kërkojë gjithashtu një vlerësim të detajuar të mirëqeverisjes korporative dhe rekomandime për mënyrën sesi mund të implementohen në KESH standartet më të mira ndërkombëtare në përputhje me normat dhe kodet ndërkombëtare.

Informacion për Klientin

KORPORATA ELEKTRO-ENERGJITIKE SHQIPTARE (KESH)

KESH sh.a është ndërmarrje 100% shtetërore për gjenerimin e energjisë elektrike, aktive në gjenerimin dhe furnizimin me energji. KESH siguron rreth 70% të kërkesës vendase për energji përmes gjenerimit nga vetë KESH.

Përmbledhja e Financimit të BERZH

218,000,000.00 Euro

218 milionë euro hua me garanci sovrane e cila do të ndahet në dy transhe. Përfshirja e bankave tregtare në bashkëfinancim do të shqyrtohet, kryesisht për transhin e dytë.

Kostoja Totale e Projektit

218,000,000.00 Euro

Shuma e plotë e huasë do të përdoret për rifinancimin e borxhit afatshkurtër.

Përmbledhja Sociale dhe Mjedisore

Kategorizuar B (2014). Ristrukturimi i KESH nuk lidhet me asnjë aktivitet ose zhvillim të ri infrastrukturor që mund të klasifikohet si kategoria "A".

Një due diligence mbi standartet mjedisore dhe sociale të KESH në nivel korporate u krye nga një konsulent i pavarur. Due diligence përfshinte vizita në njësitë kryesore të prodhimit të KESH (përfshirë hidrocentralin më të madh dhe TEC-in jo operativ të Vlorës) si dhe takime me departamente të ndryshme të Kompanisë dhe menaxherët përgjegjës për: burimet njerëzore, sigurinë dhe shëndetin në punë, marrdhëniet publike, dhe mjedisin. Performanca mjedisore, sociale dhe e sigurisë dhe shëndetit e Kompanisë përgjatë viteve të fundit u krahasua me legjislacionin shqiptar dhe Standartet e Performancës së BERZH.

Informacioni i marrë tregoi se Kompania operon në përputhje me legjislacion kombëtar. Gjithsesi, u identifikuan një numër masash të cilat duhet të ndërmerren nga KESH për të operuar në përputhje me Standartet e Performancës së BERZH dhe me objektivat relevante të direktivave të aplikueshme të BE-së, si Direktiva e Platformës për Ujin. Këto masa janë

përfshirë në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social i cili është në proces dakordësimi me KESH dhe mbi të cilin duhet të bihet dakort plotësisht përpara nënshkrimit të marrëveshjes së financimit. Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social përfshin masa në nivel korporate (si prsh. zhvillimi i një sistemi të menaxhimit mjedisor dhe social, përmirësimi i angazhimit të grupeve të interesit dhe përgatitja/implementimi i një politike të burimeve njerëzore) ose specifike për njësi (prsh në lidhje me shqetësimet mjedisore dhe sociale rreth TEC-it të Vlorës ose HEC-it të Drinit). Due diligence tregoi se Projekti nuk do të rezultojë në shkurtime.

Projekti i Ristrukturimit nuk është subjekt i vlerësimit të ndikimit mjedisor nën legjislacionin shqiptar dhe nuk është subjekt i standarteve të BERZH për Vlerësimin e Gazeve Greenhouse.

Implementimi efektiv i Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social do të jetë subjekt i veprimeve specifike monitoruese nga një konsulent i pavarur. Projekti do t'i nënshtrohet monitorimeve standarte vjetore mjedisore dhe sociale.

Bashkëpunimi Teknik

Asistenca teknike do të ofrohet për kompaninë në kuadër të:

1) Due diligence Sociale dhe Mjedisore të Korporatës

Vlerësimi Mjedisor dhe Social i kompanisë do të ndërmerret me qëllim ofrimin e rekomandimeve për menaxhimin mjedisor dhe social në kompaninë e restrukturuar dhe për të asistuar KESH në zhvillimin e një restrukturimi afatgjatë mjedisor dhe social.

2) Mirëqeverisjen e Korporatës

Asistenca synon të mbështesë KESH në konsolidimin e praktikave të mirëqeverisjes së korporatës në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira (best practices) dhe në forcimin e legjislacionit dhe kuadrit rregullator shqiptar për mirëqeverisjen korporative me qëllim akomodimin e përmirësimeve në KESH.

3) Menaxhimi i Riskut Hidrologjik

Asistenca synon rritjen e kapaciteteve të KESH për parashikime afatgjata dhe të përmirësuara hidrologjike dhe menaxhimin e tyre.

Informacion mbi Kontaktin e Shoqërisë

Ani Spahiu, Taulant Hoxha
spahiu@kesh.al, hoxhat@kesh.al
+35542228434
+355 4 2232046
www.kesh.al
#Vasil Shanto, Rruga Viktor Eftimiu. Tiranë, 1000 Albania

Mundësi biznesi

Për mundësi biznesi ose prokurime, kontaktoni shoqërinë, klientin.

Për projekte të sektorit shtetëror vizitoni faqen e Prokurimeve të BERZH

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Për pyetje mbi projektet e BERZH që nuk lidhen me prokurimet:

Tel: +44 20 7338 7168; Fax: +44 20 7338 7380

Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika e Informimit Publik (PIP)

PIP përcakton mënyrën se si BERZH jep informacion dhe këshillohet me grupet e saj të interesit në mënyrë që të promovojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimin e strategjive, politikave dhe aktiviteteve të saj.

Teksti i PIP mund të gjendet në: <http://www.ebrd.com/about/policies/pip/index.htm>

Mekanizmi i Ankesave për Projektet (MAP)

BERZH ka krijuar Mekanizmin e Ankimimeve për Projektet (MAP) për të ofruar një mundësi për një shqyrtim të pavarur të ankesave nga një ose me shumë individë ose nga organizata për projektet e financuara nga Banka të cilat pretendohet të kenë shkaktuar ose që do të shkaktojnë efekte negative.

Rregullat e Proçedurës së MAP mund të shihen në:
<http://www.ebrd.com/about/integrity/irm/about/pcm.pdf>

Cdo ankesë sipas Mekanizmit të Ankesave për Projektet duhet të dërgohet brenda afateve të përshkruara në kodin e Rregullave dhe Proçedurave të MAP. Ju mund të kontaktoni për ndihmë stafin e MAP në (pcm@ebrd.com) nëse jeni të paqartë mbi vlefshmërinë e ankesës tuaj.